



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I MINISTRAVE**  
**KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

**MARRËVESHJE**

**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE**

Sot, më datë, 26.07.2018, Palët e mëposhtme:

**Këshilli Kombëtar i Territorit**, përfaqësuar nga Kryeministri dhe Kryetari i KKT  
Z. Edi Rama

dhe

**Bashkia Tiranë**, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Erion Veliaj

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të Kodit të Procedurave Administrative; neneve 14/1, pika 2, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjit Nr. 115/2014, datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar dhe Lejes së Zhvillimit të miratuar me Vendimin e KKT-së Nr.05, datë 26.07.2018, për zonën e Bulevardit, Parkut Qendror dhe Lumit të Tiranës, bien dakord si më poshtë:

**NENI 1**  
**OBJEKTI**

- 1.1 Objekti i kësaj marrëveshje është delegimi i kompetencave Bashkisë Tiranë për kryerjen e procedurave përkatëse ligjore, në përputhje me legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, në lidhje me ndërtimin e objekteve të përfshira në Zonën e Bulevardit, Parkut Qendror dhe Lumit të Tiranës, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues Bashkinë Tiranë, sipas Lejes përkatëse të Zhvillimit, të miratuar me vendimin e KKT-së Nr.05, datë 26.07.2018.



## NENI 2 KOHËZGJATJA

Kompetencat objekt i kësaj Marrëveshjeje do të ushtrohen nga Bashkia Tiranë, nga data e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje e deri në vënien në shfrytëzim të objekteve të përfshira në Zonën e Bulevardit, Parkut Qendror dhe Lumit të Tiranës, Bashkia Tiranë.

## NENI 3 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

- 3.1 Këshilli Kombëtar i Territorit ka të drejtat dhe detyrimet si më poshtë:
- i. Vënien në dispozicion të Bashkisë Tiranë të Lejes së Zhvillimit të miratuar me vendimin e KKT-së Nr.05, datë 26.07.2018, për “Zonën e Bulevardit, Parkut Qendror dhe Lumit të Tiranës, Bashkia Tiranë”, me subjekt zhvillues Bashkinë Tiranë.
- dhe
- ii. Dokumentet e poshtëshënuara pjesë përbërëse të vendimit të KKT-së
    - a) Dokumenti i Manualit “Për miratimin e lejes së zhvillimit për zonën e Bulevardit, Parkut Qendror dhe Lumit të Tiranës”;
    - b) Harta e Përdorimit të propozuar të tokës;
    - c) Harta e Intensitetit të propozuar të ndërtimit;
    - d) Harta e Rrjetit rrugor të propozuar.
- 3.2 Bashkia Tiranë ka të drejtat dhe detyrimet si më poshtë:
- i. Kryerjen e të gjitha procedurave administrative/ligjore, sipas përcaktimeve të parashikuara në dispozitat e Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, për objektet e përfshira në Zonën e Bulevardit, Parkut Qendror dhe Lumit të Tiranës, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues Bashkinë Tiranë;
  - ii. Shqyrtimin, verifikimin dhe vlerësimin e dokumentacionit përkatës teknik; të dokumenteve që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin

SHILLI MINIS

pjesë në këtë zhvillim, si dhe të çdo akti/dokumenti tjetër ligjor, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

- iii. Miratimin dhe lëshimin e akteve/dokumenteve përkatëse, të parashikuara në legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, për Zonën e Bulevardit, Parkut Qendror dhe Lumit të Tiranës, Bashkia Tiranë.

#### NENI 4

#### ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- 4.1 Palët do t'i zgjidhin të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje me mirëkuptim ndërmjet tyre.

#### NENI 5

#### GJUHA E MARRËVESHJES

- 5.1 Kjo marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën Shqipe me vlerë të njëjtë.

#### NENI 6

#### EFEKTET JURIDIKE DHE PUBLIKIMI

- 6.1 Palët bien dakord se efektet juridike të kësaj Marrëveshjeje do të fillojnë në momentin e nënshkrimit të saj.
- 6.2 Kjo Marrëveshje publikohet në Fletoren Zyrtare.

#### PALËT

#### KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

Përfaqësuar nga,  
**Z. EDI RAMA**



#### BASHKIA TIRANË

Përfaqësuar nga,  
**Z. ERION VELIAJ**

